



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. _____ Prot

Kamëz më _____.____.2010

V E N D I M

Nr.____, datë____.____.2010

**“PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË
BASHKINË KAMËZ PËR VITIN 2011”**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë _____.____. 2010 në mbështetje të nenit 16 pika 2, 3 dhe 4, nenit 32, germa “f” e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit nr. 9632 datë 31.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 10146, datë 29.9.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9727 datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimorë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit të përbashkët nr. 655/1, datë 6.2.2007 të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe raportimit të taksave vendore”, udhëzimit të ministrit të Financave nr. 1, datë 12.1.2007, “Për përcaktimin e veprimtarive që përcaktohen si veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”, pas shqyrtimit të relacionit nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore:

V E N D O S I:

- 1) Miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Kamëz për vitin 2011 të cilat në substancë do të jenë të njëjta edhe për vitet 2012-2013.

I. TAKSAT VENDORE

1.1 TAKSAT MBI PASURITË E PALUAJTSHME

	Emërtimi	Taksa për m ² /vjetore (lekë)
A-	Ndërtesa banimi:	
	a- të ndërtuara para vitit 1993	6.5
	b- të ndërtuara pas vitit 1993	7.5
B-	Ndërtesa të tjera:	
	a- Ndërtesa për aktivitet ekonomik si tregti, shërbime administrative, shëndetësore, artizanale, komunale, social-kulturore, arsimore e shkencore, prodhimi e shërbimi ku të gjitha rrugët brenda territorit të Bashkisë Kamëz janë të shtruara me asfalt.	150
	b- Për sipërfaqet jashtë ndërtesës, të shfrytëzueshme për aktivitet tregtar, për grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e inerteve dhe materialeve të ndërtimit, për lavazhe dhe servise që ndikojnë në infrastrukturë, që ndotin ambientin.	
	-Për subjektet të cilësuar biznes i madh VIP	80
	-Për subjektet të cilësuar biznes i madh	60
	-Për subjektet të cilësuar biznes i vogël	40
C	Taksat mbi token bujqësore	Taksa për ha/vjetore (lekë)
	-Taksa mbi tokën bujqësore për territorin e Bashkisë Kamëz, ku, sipas klasifikimit të Ministrisë së Bujqësisë, është kategori e tretë.	4.000

Për piken a dhe b, taksa për banesat (kategoria familjare), do të aplikohet një taksë fikse prej **1.200 lekësh në vit** për çdo familje, deri në plotësimin e dosjeve nga ana e familjarëve me dokumentacionin e plotë ligjor (hipotekimin).

- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, kategoria A, B dhe C, ndërtesa të tjera, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kamëz.

- Taksat mbi token bujqësore është një detyrim vjetor, i cili paguhet brenda 6-mujorit të parë të vitit ushtrimor. Mbledhja e kësaj takse bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet agjentëve tatimorë të caktuar për këtë qëllim.

1.2 TAKSË PËR FJETJE NË HOTEL

Baza e taksës së fjetjes në hotel është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë. Janë subjekt i taksës të gjitha hotelet, motelet, stabilimentet turistike, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

- Taksa për fjetje në hotel mbi çmimin e dhomës për person.	5%
---	-----------

1.3 TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Nr	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja	Në %
1.	Objekte banimi deri në 3 kate	
	Studim urbanistik	1
	Ndikim në infrastrukturë	1
	Totali	2
2.	Objekte administrative, shërbimi dhe industriale	
	Studim urbanistik	1
	Ndikim në infrastrukturë	2.5
	Totali	3.5
3.	Objekte me qëllime publike, private dhe shtetërore, si: spitale, shkolla, kopshte dhe infrastrukturë rruge, ujësjellës-kanalizime	
	Studim urbanistik	1
	Ndikim në infrastrukturë	1
	Totali	2
4.	Objekte shumëkatëshe etj.	
	Studim urbanistik	1
	Ndikim në infrastrukturë	2
	Totali	3
5	Ndërtesa në proces legalizimi	0.5

Struktura për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Kamëz dhe agjenti tatimor përkatës.

1.4 TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Kjo taksë aplikohet mbi të gjitha subjektet, të cilat shfrytëzojnë hapësirat publike për të kryer aktivitete të ndryshme. Baza e taksës për zënie e hapësirës publike për qëllime veprimtarie ekonomike fitimprurëse është sipërfaqja në metër katror, që vihet në shfrytëzim nga subjekti për ushtrim aktiviteti dhe llogaritet me bazë mujore.

	Emërtimi	Takse për m ² (lekë/muaj)
a-	- Për subjektet të cilësuar biznes i madh	80
c-	-Për subjektet të cilësuar biznes i vogël	40

1.4/1 TAKSA PËR VENDET E TREGUT PUBLIK

	Emërtimi	Takse për m²/ditore (lekë)
a-	Tregu fruta dhe perime	50
b-	Tregu bulmet, mish dhe peshk	50
	Tregu industrial	50

1.4/2 TAKSA PËR MALLRA JASHTË VENDEVE TË TREGUT PUBLIK

	Emërtimi	Taksë për m²/ditore (lekë)
a-	Vende tregtimi shtypi, librash etj.	60
b-	Tregtare jashtë tregjeve publike, për fruta, perime e bulmet, koeficienti 1.2	70
c-	Tregtare jashtë tregjeve publike, për artikuj industriale, koeficienti 1	30
d-	Për spektakle ose panaire të ndryshme	20
	Objekte të përkohshme, me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar (Sipërfaqe të zëna me platforma ndërtimore, sipërfaqe të rrethuara me rrethime provizore, vazo, kangjella etj.)	
	- Për personat fizikë	30
	- Për personat juridikë	60

Në rast të shfrytëzimit të hapësirave publike për qëllime tregtare, me objekt si tavolina, që nuk kategorizohen në pikat më sipër, përlllogaritja e taksës bëhet sipas nivelit **20 lekë për tavolinë në ditë**.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës për zënien e hapësirave publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet inspektorit të tregut dhe specialistëve të saj.

1.4 TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin emërtimin e subjektit në pamje ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi, si për subjektet fizike dhe ato juridike.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim vjetor për të gjitha subjektet, me përjashtim të ambulanteve.

	Emërtimi	Taksë për copë/vjetore (lekë)
	Tabelë e shprehur në shqip dhe gjuhë të huaj	

	-Për biznesin e vogël	120
	-Për biznesin e madh	120

Tabelat identifikuese, sipërfaqja e të cilave kalon mbi 4 m², do të quhen tabela reklamuese dhe pavarësisht vendit ku janë vendosur, do të llogariten si sipërfaqe të reklamueshme me taksën për metër katror të reklamës sipas germës E, pika 1 (Tarifa e reklamës).

Struktura për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

1.5 /1 TAKSA E PËRKOHSHME E GJELBËR

Taksa e gjelbër paguhet nga të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që punojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Kamëz. Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të taksës së përkohshme të gjelbër janë si më poshtë:

Emërtimi		Niveli i taksës sipas llojit të aktivitetit, vjetore (lekë)	
		Biznes i vogël	Biznes i madh
I	Çdo familje 100 lekë/vit		
II	Veprimtari ekonomike të veçanta		
-	Njësi prodhimi:		
A	-Prodhim, përpunim ëmbëlsirash dhe produkte ushqimore	2000	5000
B	-Prodhim dhe përpunim pijesh	2000	5000
C	-Prodhim dhe përpunim druri, mobiliesh, tapiceri	2000	5000
D	-Impiante prodhimi dhe përpunimi metalesh	2000	5000
E	-Prodhim dhe përpunim materiale inerte	2000	5000
F	-Prodhim, përpunim qumështi dhe nënproduktesh të tij	2000	5000
G	-Prodhim konfeksionesh	2000	5000
DH	-Prodhim dhe përpunim i letrës, kartonëve, plasmasit	2000	5000
H	-Prodhim dhe përpunim vajrash, naftë, gazit etj.	2000	5000
I	-Impiante,territore për therjen e kafshëve	2000	5000
J	-Shtypshkronja	2000	5000
K	-Prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike	12,500	50,000
L	Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolle, kopshti, objekte banimi e tregtare dhe të tjera të ngjashme me to)	12,500	50,000
M	Njësi ndërtimi(objekt familjar deri në 3 kate) Njësi ndërtimi (objekt familjar mbi 3 kate)		20,000 50,000
-	Njësi shërbimi		
N	-Klinikë mjekësore, laborator, farmaci, spital, maternitet	3500	5000
O	-Bar -restorantet	3500	5000
P	-Fast food	2500	5000

Q	-Njësi shërbimi Non stop (pub, diskotekë etj.)	5000	6000
	-Hotele	5000	6000
R	-Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës, këpucar, floktore, orëndreqës etj.	2500	2500
S	-Shkolla, kopshte, çerdhe, qendra kulturore, stadione, komplekse sportive, palestra, fitnes, pishina, qendra dhe institute kërkimore-shkencore, qendra interneti, salla koncertesh dhe mbledhjesh, videoteka e biblioteka	3500	5000
III	-Njësi të tjera si shitje me pakicë artikuj ushqimorë, industrialë etj. (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë e mësipërme)	2000	5000

Detyrimi për taksën e gjelbër është detyrim vjetor. Afati i shlyerjes së saj është data 20 prill e vitit fiskal aktual.

Për kategorinë **II-M** taksa do të llogaritet nga momenti i fillimit të punimeve deri në marrjen e lejes së shfrytëzimit në organin përkatës.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së përkohshme të gjelbër është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz.

1.5/2 TAKSA e GJUE TISË

Kjo taksë gjen mbështetje në ligjin nr. 9219, dt. 8.4.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime” në ligjin nr. 7875, dt. 23.11.1994, “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetisë”. Detyrimi për pagimin e kësaj takse i takon çdo personi fizik, juridik që ushtron gjuetinë dhe që banon në territorin e Bashkisë Kamëz. Vlera e përcaktuar sipas ligjeve të mësipërme, është **1.500 lekë në vit**.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kamëz.

II. TARIFAT VENDORE

A.1 TARIFAT E REGJISTRIMIT PËR VEPRIMTARI TË NDRYSHME

Kjo tarifë paguhet vetëm një herë, me çeljen e regjistrimit fillestar të subjektit dhe veprimtarisë së tij ekonomike.

	Emërtimi	Tarifa (lekë)
1.	- Për persona juridikë, shtetërorë e privatë, vendas e të huaj	20000
2.	- Për persona fizikë	7000
3.	- Për persona ambulantë, për tregti e shërbime	1.500

Struktura për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz.

A.2 TARIFAT E DHËNIES SË LEJEVE NGA BASHKIA, PËR ZHVILLIM AKTIVITETI

Këto tarifa zbatohen për disa lloje aktivitete të kufizuara nga bashkia në qytet dhe në vende të populluara, sepse zgjerimi i tyre në mënyrë të pakufizuar sjell vështirësi në shërbimet që i ofrohen komunitetit.

	Lloji i aktivitetit	Tarifa (në vit, lekë)
1.	-Servis me një repart shërbimi	1.000
2.	-Servis më dy reparte shërbimi	2.000
3.	-Lavazhe	1.000
4.	-Parkime automjete, për një vend parkimi	1.000
5.	-Subjekt për destinacion parkimi automjete, për çdo vend parkimi	1.000
6.	-Depozitim materiale shërbimi në sipërfaqe të hapura private apo publike	5.000
7.	-Tregtim artikujsh industrialë, ushqimorë, të përzier, bar-kafe dhe shërbime artizanale	1.000
8.	-Lokale dhe shërbime nate, pas orës 22:00	15.000

Agjenti tatimor për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Kamëz.

B. TARIFAT E PAGESËS PËR LICENCAT DHE CERTIFIKATAT NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE QË LËSHOHEN NGA PUSHTETI VENDOR

Nr	EMËRTIMI	TARIFA (lekë)	TARIFA (lekë)	Tarifa e pastrimit për çdo automjet tërheqës
	1. LICENCAT	1-vjeçare	3-vjeçare	Tarifë vjetore (lekë)
1.	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt në qytet	-	24.000	10.000
2.	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rreth qytetit	-	12.000	10.000
3.	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt midis qytetesh, brenda qarkut	-	45.000	10.000
4.	Licencë për transport udhëtarësh me taksi brenda	Për mjet	5-vjeçare	(8+1) 7.500 (4+1) 5.000

	vendit		20.000	
5.	Licencë për agjenci transport udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	-	9.000	-
6.	Licencë për transport mallrash: -Persona juridikë për të tretë dhe me qira brenda vendit -Persona fizikë për të tretë dhe me qira brenda vendit.	- -	24.000 24.000	5.000 1.000
7.	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërmjet qarqeve	Për linjë	45.000	10.000
8.	Licencë për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh	-	24.000	
9.	Licencë për transport ndërkombëtar udhëtarësh	-	45.000	
	2. CERTIFIKATAT			
10.	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt në qytet	1.000	-	-
11.	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt midis qytetesh brenda qarkut	Për mjet në vit 1.500	-	-
12.	Autorizim i përkohshëm njëmuor	2.000	-	-
13.	Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet	100 lekë/ton kapacitet	-	-
14.	Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	100 lekë/ ton kapacitet	-	-
15.	Certifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt midis qyteteve, ndërmjet qarqeve	Për mjet 1.500	-	-

Shënim: Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat, vlefata paguhet 30% e vlerës së plotë. Struktura për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Kamëz.

C. TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE

	Kategoritë dhe llojet e automjeteve	Tarifa (për orë, lekë)
A.	Parkime ditore	
1	Parkimi i autobusëve në vende të caktuara, në territore publike	100
2.	Parkimi i autoveturave në vende të caktuara, në territore publike	20
3.	Parkimi i kamionëve të llojeve të ndryshme nga 2.5 deri 16 tonë	200
B.	Parkimi i automjeteve në vende publike apo private, para lokaleve, në vende të caktuara	Tarifa/vend (vjetore)
1	Në vende publike apo private, para lokaleve të shërbimit	1.000
2	Në vende të caktuara për parkime të rrethuara	10.000
3.	Tarifë parkimi për çdo mjet të linjave rreth qytetit dhe midis qyteteve.	10.000

Struktura për vjeljen e këtyre tarifave të mësipërme do të jetë Drejtoria e Shërbimeve Publike.

C.1. TARIFA PËR DHËNIËN E LICENCEVE PERSONALE DHE PROFESIONALE PËR MBETJET E NGURTA DHE FUNERALE

Nr	Emërtimi	Tarifa vjetore
1	Licencë profesionale dhe personale	2000
2	Licencë profesionale për subjekt	
	-Persona fizikë	10,000
	- Persona juridikë	20,000
3	Shtesë pikash në licencë profesionale personale	10,000
4	Shtesë pikash në licencë të subjekteve	
	-Persona fizikë	5000
	-Persona juridikë	10,000
5	Zgjatje afati licence subjekti	5000
6	Ndryshim drejtësi teknik të subjektit	5000
7	Dublikatë licence personale	500
8	Dublikatë licence subjekti	1000

Për vjeljen e kësaj tarife ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Kamëz.

C.2. TARIFË PËR PLOTËSIM KARTONI PËR KOMUNAT QË I KORRESPONDOJNË BASHKISË KAMËZ

Tarifa për plotësim kartoni të fugonëve taksi (8+1) dhe (4+1) të komunave që i korrespondojnë Bashkisë Kamëz është **3.000 (tre mijë) lekë**.

Agjenti tatimor për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Kamëz.

D. TARIFË PËR SHËRBIMET FUNERALE

Për çdo varrim që kryhet nga agjencitë funerale në territorin e Bashkisë Kamëz, tarifa është **1.500 lekë**. Kjo tarifë do të paguhet nga agjencitë funerale të licencuara. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Kamëz.

D.1. TARIFA E PASTRIMIT, LARGIMIT DHE KOMPOSTIMIT TË MBETURINAVE

	Emërtimi	Tarifa (vjetore, lekë)
A-	PËR FAMILJARË	
1.	Për të gjitha familjet në juridiksion të Bashkisë Kamëz	1200
B-	PËR NJËSITË TREGTARE	
1	Për tregtarët e bulmetit, mishit, peshkut	15,000
2	Për tregtarët e fruta-perimeve dhe ushqimeve	15,000
3	Për tregtarët e artikujve industrialë	15,000
4	Për bare, restorante, kafene, bar-kafe, diskoteka	15,000
5	Për hotele, motele, komplekse turistike lekë/dhomë/vit	1000
6	Për organizata shoqërore, fondacione	5000
7	Për institucionet social-kulturore, shkolla, kolegje shtetërore ose private	20,000
8	Për bilardot	15,000
9	Për këndet sportive (fusha minifutbolli) e të tjera të kësaj natyre	20,000
10	Për lojërat e fatit subjektet e biznesit madh	50,000
11	Për çdo njësi shërbimi dhe artizanati:	
	-Kur veprimtaria klasifikohet biznes i vogël	15,000
	- Kur veprimtaria klasifikohet biznes i madh	50,000
	-Kur subjektet klasifikohen biznes i madh farmaci	25,000
12	Për njësi prodhimi:	
	- Kur veprimtaria klasifikohet biznes i vogël	20,000
	- Kur veprimtaria klasifikohet biznes i madh	70,000
13	Për subjektet e ndërtimit të klasifikuara biznes i madh	70,000
14	Për subjektet e mëdha të klasifikuara kompani VIP	120,000
15	Për subjektet që klasifikohen si ambulante	1500
16	Mjedise administrative	

	-a. Shtetërore	0
	-b. Private	5000
17	Ndërmarrje/ Institucione	
	- Bankat	50,000
	- Albtelekom	30,000
	- Filiali i Postës	20,000
	- Zyra a Punës	5000
	- Zyra e Bujqësisë	5000
	- Agjencia e Sigurimeve Shoqërore	5000
	- Komisarati i Policisë nr. 5	5000
	- Kompani sigurimesh	5000
	- Agjenci të këmbimit valutor, fondacione e të ngjashme me to.	5000
	- Të tjera publike e private	5000
18	Tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave për familjet që ndërtojnë dhe pajisen me leje ndërtimi nga KRRT e Bashkisë Kamëz për çdo banesë;	
	- deri në 3 (tre) kate ndërtim	20,000
	- mbi 3 (tre) kate ndërtim	70,000

Struktura për vjeljen e kësaj tarife do të jetë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz.

Detyrimi vjetor i taksapaguesit për Kategorinë A **“Familjarët”** paguhet me një këst, brenda datës 30 qershor të vitit kalendarik.

Për të gjitha subjektet e tjera Kategoria B **“Për njësitë tregtarë”** detyrimi paguhet brenda datës 20 prill të vitit ushtrimor aktual. Për subjektet e reja të regjistruara rishtazi gjatë vitit, detyrimet lindin në momentin e regjistrimit në QKR.

E .TARIFA E REKLAMËS

Tarifa e reklamës kategorizohet si më poshtë:

	Emërtimi	Tarifa lekë/m²
1	Tabelë për qëllimi reklamimi, të thjeshta dhe elektronike	13,500
2	Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda, banderola etj.	1000 lekë m²/ditë

Struktura për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kamëz.

E. 1. TARIFA PËR SHËRBIMET E URBANISTIKËS DHE ZYRËS SË ADMINISTRIMIT E MBROJTJES SË TOKËS

	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Tarifa (lekë)
1.	Akti i kontrollit të piketimit, mbarimi i themeleve		
a)	-Për objekte banimi vetjake	Lekë/njësi	5.000
b)	-Për objektet e biznesit dhe shërbimeve	Lekë/njësi	8.000
2.	Akti i kontrollit të kuotës +,- 0.00		
a)	-Për objekte banimi	Lekë/njësi	5.000
b)	-Për objektet e biznesit dhe shërbimeve	Lekë/njësi	8.000
3.	Akti i kontrollit të karabinasë		
a)	-Për objekte banimi	Lekë/njësi	8.000
b)	-Për objektet e biznesit dhe shërbimeve	Lekë/njësi	10.000
4.	Akti i kontrollit përfundimtar të objektit		
a)	-Për objekte banimi	Lekë/njësi	8.000
b)	-Për objektet e biznesit dhe shërbimeve	Lekë/njësi	10.000
5.	Kontrolli dhe dhënia e lejes së shfrytëzimit		
a)	-Për objekte shfrytëzimi me karakter industrial	Lekë/m ³	20
b)	-Për objekte vetjake	Lekë/m ³	15
6.	Konfirmimi dhe legalizimi i gent-planeve nga Urbanistika	Lekë/copë	1.500
7.	Tarifë për shfrytëzim të ujit nëntokësor nga hapja e puseve nëntokësore	Lekë/pus	3.000
8.	Tarifë për shitblerjen e tokës	Lekë/m ²	15

Struktura për vjeljen e tarifave për pikat 1, 2, 3 dhe 4 është Drejtoria e Urbanistikës, për pikën 5 është Zyra e A.M.Tokës dhe për pikën 6 është Zyra e Legalizimeve.

MIRATIMI I TARIFAVE QË DO TË APLIKOHEN PËR MARRJEN NË DORËZIM DHE PËR SHQYRTIMIN E DOSJEVE PËR LEJE NDËRTIMI

Në mbështetje të ligjit nr. 8652, dt. 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni nr. 54, pika g; të ligjit nr. 8435, dt. 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” amenduar dhe ndryshuar me ligjin nr. 8713, dt. 15.3.2000, si dhe ligjin nr. 8485, dt. 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e tarifave për shërbimet që do të aplikohen për marrjen në dorëzim dhe shqyrtimin për leje ndërtimi nga Zyra e Urbanistikës.

Për shërbimet që realizohen në Zyrën e Urbanistikës do të zbatohen këto tarifa:

1.	Shqyrtim dosje për banesa individuale	5.000 lekë
2.	Shqyrtim dosje për banesa individuale dhe shërbime	10.000 lekë
3.	Shqyrtim dosje për banesa kolektive	15.000 lekë
4.	Shqyrtim dosje për komplekse banimi	25.000 lekë
5.	Shqyrtim dosje objekte polifunksionale (lokale, shërbime) deri 4 kate	10.000 lekë
6.	Shqyrtim dosje objekte polifunksionale (lokale, shërbime) mbi 4 kate	15.000 lekë
7.	Shqyrtim dosje për objekte industriale, magazinime sip. toke deri në 3000 m ²	10.000 lekë
8.	Shqyrtim dosje për objekte industriale, magazinime me sip. toke 3000-5000 m ²	15.000 lekë
9.	Shqyrtim dosje për objekte industriale prodhimi sip. toke deri 3000m ²	20.000 lekë
10.	Shqyrtim dosje për objekte industriale prodhimi me sip. toke 3000-5000 m ²	25.000 lekë
11.	Objekte si hotele, autosallone, administrate	30.000 lekë
12.	Objekte karburanti, gazi	35.000 lekë

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Kamëz.

G. TARIFA TË SHËRBIMIT VETERINAR

	Emërtimi	Njësia	Tarifa
1	-Tarifa për lejen veterinare për njësitet e tregtimit të mishit	Për leje	2.500
2	-Tarifa e vulosjes dhe pajisja me raport veterinar për ka, lopë, mëshqerrë, viç e derr	Për krerë të therur	200
3	-Tarifa e vulosjes dhe pajisja me raport veterinar për të gjitha të imtat në përgjithësi	Për krerë të therur	50
4	-Dhënie certifikate ndërkombëtare për eksport lëkure, bretkosash , kërmijsh, peshku, leshi, mishi etj.	Për rast	2.000
5	-Kontrolli i produkteve me origjinë shtazore	Për çdo makinë	1.000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave të mësipërme, sipas pikës G, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet specialistëve veterinerë, të cilët kryejnë një veprim të tillë.

H. TARIFA PËR SHËRBIME NGA DREJTORITE DHE ZYRAT E BASHKISË

	Emërtimi	Njësia	Tarifa (lekë)
1	-Tarifa e shërbimit në arshivat e bashkisë për tërheqje dokumentacioni	Për dokument	200

2	-Tarifa e shërbimit për banorë lagje	Për copë	100
3	-Tarifa e lëshimit të vërtetimit për likuidimin e detyrimeve nga Drejtoria e Tatim-Taksave		
a	-Për subjektet që klasifikohen fizikë	Për copë	200
b	-Për personat juridikë	Për copë	500
c	-Për personat e tjerë që nuk përfshihen në pikat “a” dhe “b”	Për copë	100
4	-Tarifë shërbimi nga zyra e A.M.Tokës	Për copë	100

Struktura për vjeljen e këtyre tarifave janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Urbanistikës dhe zyrat e tjera që kryejnë shërbime ndaj personave fizikë e juridikë, shtetërorë apo privatë, vendas dhe të huaj.

I . TARIFA PËR VENDOSJE TË ANTENAVE TË TELEFONISË CELULARE

Tarifa për antenat e vendosura nga kompanitë celulare AMC sh.a, Vodafone sh.a dhe kompani të tjera të telefonisë celulare që operojnë në vend, për çdo antenë të vendosur në territorin e Bashkisë Kamëz, **tarifa vjetore do të jetë 300.000 lekë në vit.**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëpërmjet inspektorëve të saj.

I.1 TARIFË E PËRKOHSHME PËR LOJËRA FATI DHE LOTARI SPORTIVE

Të gjitha shoqëritë e basteve sportive, të licencuara në këtë fushë, në bazë të ligjit “Për kazinotë dhe hipodromet” dhe të cilat ushtrojnë aktivitet sekondar brenda ambienteve të licencuara si biznes i vogël (bar-kafe, restorant etj.), në njësinë administrative të Bashkisë Kamëz, janë të detyruara të paguajnë një tarifë vendore fikse **prej 20.000 lekësh në vit**, përveç taksave dhe tarifave të tjera që u takojnë me ligj.

Struktura për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kamëz.

TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL

Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, qoftë ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, me anë të cilit realizohet një e ardhur bruto vjetore (qarkullim), më e vogël ose e barabartë me 8.000.0000 lekë.

Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda **datës 20 prill**. Kësti i dytë deri brenda **datës 20 korrik**. Kësti i tretë deri më datën **20 tetor** dhe kësti i fundit jo më vonë sa data **20 janar** e vitit të ardhshëm fiskal.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Kamëz.

Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël paraqiten si më poshtë:

Niveli tregues i taksës në lekë

Nr	XHIROJA E AKTIVITETIT (në 000 Lekë)	Deri 2.000	2.000 - 3.000	3.000 - 4.000	4.000 - 5.000	5.000 - 6.000	6.000 - 7.000	7.000 - 8.000
a)	SHITJE ME PAKICË	26,000	50,000	66,000	82,000	99,000	115,000	132,000
a.1)	Bylmet, mish, peshk							
a.2)	Fruta, përime, ushqimore							
a.3)	Artikuj industrialë (veshje, parfumeri, argjendari)							
a.4)	Bar, restorant, pub, diskoteka, lojëra fati							
a.5)	Fast food, kafe-internet							
a.6)	Të tjera të ngjashme me to							
b)	SHITJE ME SHUMICË	26,000	50,000	66,000	82,000	99,000	115,000	132,000
b.1)	Magazina, dyqane etj., të cilat realizojnë shitje me shumicë							
c)	PROD HIM	22,000	47,000	52,000	80,000	96,000	115,000	129,000
c.1)	Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie letre, kartoni, plasmasi etj. të ngjashme me to							
c.2)	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje, nyje inerte etj. të ngjashme me to							
c.3)	Prodhime ushqimore, bukë, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj.							
c.4)	Prodhim konfeksione etj. të ngjashme me to							
c.5)	Prodhim, përpunim vajrash, naftë, gazi e nënprodukte etj.							
c.6)	Impiante, territore për therjen e kafshëve etj.							
c.8)	Prodhim, produkte farmacie							
d)	SHËRBIME	22,000	47,000	69,000	87,000	96,000	113,000	129,000
d.1)	Riparimi i artikujve elektro-shtëpiakë: radio, televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofona, pajisje fonie etj.							

d.2	Shërbime të fotokopjimit, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina (autoshkolla), traktorë, kompjuter, parukeri, agjenci doganore, agjenci këmbimi valute, agjenci turizmi, motele, pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkimi i makinave, lavanteri, pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojërave të ndryshme (gjimnastikë, aerobi, cirk), kënde lojërash për fëmijë, pingpong dhe të tjera shërbime të ngjashme me shërbimet e lartpërmendura							
e)	PROFESIONE TË LIRA	25,000	49,000	66,000	82,000	99,000	115,000	132,000
e.1	Avokat, noter, mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, ekonomist kontabël i miratuar, ekspert kontabël i autorizuar, mësues, veteriner, agronom, botues, inxhinier, arkitekt, projektues e të tjera profesione të lira, të cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme							
e.2	Galeritë e artit të piktorëve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë, që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike							
e.3	Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet, çerdhet), shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostikimi etj. në rastet kur nuk e kalojnë kufirin e regjistrimit në TVSH							
f)	AMBULANTË	5,000						
	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private							

TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT

Baza e taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Niveli i taksës shprehet në kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit, kategorisë dhe nivelit. Sipas mjeteve, përcaktohet në **Aneksin 4** "Taksa vjetore për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve", ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore".

Agjent tatimor për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, të cilat në rolin e agentit për këtë taksë përfitojnë 5% dhe 1% të shumës së arkëtuar.

NDËRMARRJA E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

arifat e pagesës së ujit për personat fizikë, familjarët, entet shtetërore dhe personat juridikë janë si në tabelën e mëposhtme:

Nr	PËRSHKRIMI	ÇMIMI
1	Lidhje kontrate uji për biznese dhe KUN	7000 lekë
2	Lidhje kontrate uji për familje dhe KUN	3000 lekë
3	Gen-plane dhe azhurnime	5000 lekë
4	Ndryshim kontrate	1000 lekë
5	Libreza uji	100 lekë
6	Pagesë e ujit për entet shtetërore me matës	200 lekë m ³
7	Pagesë e ujit për subjektet private me matës, të ndara sipas bizneseve	200 lekë m ³
8	Pagesa e ujit për aktivitete private, çmimi dysHEME	1000 lekë në muaj
9	Pagesa e ujit afrofe për aktivitete private të kësaj kategorie (banka, shkolla private, konvikte, firma ndërtimi)	4000 lekë në muaj
10	Pagesa e ujit afrofe për aktivitete private të kësaj kategorie (dyqane, parukeri, butik dhe farmaci)	1500 lekë në muaj
11	Pagesa e ujit afrofe dhe KUN për abonentët familjarë për zonat: Kamëz, Valias, Frutikulturë, Zall-Mner	800 lekë në muaj
12	Pagesa e ujit afrofe dhe KUN për abonentët familjarë për zonën e Bathores dhe të Paskuqanit	700 lekë në muaj

Struktura e ngarkuar për vjeljen e këtyre tarifave është Drejtoria Ujësjiellës-Kanalizimeve pranë Bashkisë Kamëz, me punonjësit e saj të caktuar për këtë qëllim.

Në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", propozojmë që Policia Bashkiake të ndërhyjë në të gjitha rastet që do të kërkohej nga Drejtoria e

Taksave dhe Tarifave Vendore, kjo për një efikasitet më të lartë dhe uljen në maksimum të informalitetit apo të rasteve të mospagimit në kohë të detyrimeve tatimore.

Për sa i përket parashikimit për Paketën Fiskale për vitin 2012-2013, Bashkia Kamëz nuk parashikon ndryshime substanciale, përjashtimisht për ndryshimet që mund të ndodhin në legjislacionin tatimor, të urbanistikës apo të legjislacionit për transportin publik dhe licencimet në këtë fushë (transportin publik).

SEKRETARI

KRYETARI

Sokol NDREU

Bilbil BAJRAKTARI